



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-5755 dt. 06.02 2025

PROCESVERBALI

i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më 22.01.2025, e cila filloi në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Bekim Lestrani - kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, ku të pranishëm ishin: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN). Florentina Elezi-Veliu (VV), Hamit Kastrati (PDK).

Mbledhja do të ketë këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.12.2024.
2. Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2024.
3. Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.02-400/01-57008, dt 29.11.2024 për miratimin e Raportit të Komisioneve Komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
4. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara.
5. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
6. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2024
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe hodhi në votim rendin e ditës dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës 1.Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 19.12.2024, diskutime nuk pati dhe kaloi në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2.Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2024, pasi nuk pati vërejtje sugjerime, hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3.Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.02-400/01-57008, dt 29.11.2024 për miratimin e Raportit të Komisioneve Komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, pasi nuk pati vërejtje sugjerime, hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4.Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara, pasi nuk pati vërejtje sugjerime, hodhi në votim pikën e katër të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 5.Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, pasi nuk pati vërejtje sugjerime, hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Hamit Haxhiu, a bënë me ditë për çka është fjala propozim vendim për ndryshim për çfarë ndryshimi bëhet për rregullore, për taksa për tarifa për çfarë ndryshimi.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, i keni disa pika pesë ose gjashtë nuk jam i sigurt që ka ndryshuar ligji dhe ne duhet me i harmonizuar në bazë të ligjeve të reja.


Arbër Halilaj, përshëndetje për të gjithë kisha vetëm me ngritë si çështje si pyetje, a ka ndërmend komuna që të bëj diçka për bizneset që operojnë afër sheshit se po ankohen se ju ka rënë qarkullimi për shkak të punimeve që janë duke u bërë në shesh dhe vazhdojnë të jenë .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 6.Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2024 si nuk pati vërejtje sugjerime, hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 11.Të ndryshme.
Diskutime nuk pati, dhe mbledhja përfundoi në ora 10:20.


Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Bekim Lestrani